



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit

P-073

Prishtinë, më 7 korrik 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-31

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 7 KORRIK 2009

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Ibrahim Gashi dhe Slllobodan Petroviq, kurse munguan Mufera Shinik dhe Nexhat Daci.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga OSBE-ja: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 korrik 2009,
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave,
3. Shqyrtimi i Përfundimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me kërkesën e Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03-L-040 për vetëqeverisjen lokale,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar “7+”-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
5. Të ndryshme.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 korrik 2009**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 korrik 2009, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

#### **3. Shqyrtimi i Përfundimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me kërkesën e Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-040 për vetëqeverisjen lokale**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

1. Kryesia e Kuvendit mbështeti Përfundimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me kërkesën për rishqyrtim të propozimit të Organizatës së Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03-L-040 për vetëqeverisjen lokale.

2. Me Përfundimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të njoftohet propozuesi, përkatësisht Organizata e Shoqërisë Civile.

#### **4. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar “7+” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi**

**Kryesia** vendosi që kërkesën e Grupit Parlamentar “7+” ta radhisë në rend dite të seancës plenare.

#### **5. Të ndryshme**

##### **5.1 Kryesimi i seancave plenare**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi propozimin për kryesimin e seancave plenare, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Në kryesimin e punës të seancës plenare të datës 9 korrik 2009, Kryetarin e Kuvendit do ta ndihmojnë, në pjesën e parë, anëtari i Kryesisë, z. Nexhat Daci, kurse , në pjesën e dytë, anëtari i Kryesisë, z. Xhavit Haliti.

##### **5.2 Njoftimi i anëtarit të Kryesisë Sllobodan Petroviq lidhur me ndërprerjen e kontratës së qirasë**

**Kryesia**, pasi u njoftua me kërkesën e anëtarit të Kryesisë, Sllobodan Petroviq, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Kryesia e Kuvendit miratoi kërkesën e anëtarit të Kryesisë, z. Sllobodan Petroviq, për ndërprerjen - shkëputjen e kontratës së qirasë të paguar në emër të Kuvendit, për arsye të kalimit me banim në shtëpinë e tij private, duke filluar nga muaji korrik 2009.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup Krasniqi**

---

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**